

Akti i themelimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar TECHACADEMY SHPK

NENI 1

EMRI I SHOQËRISË

Prej shtetases shqiptare znj. MIRBANA LAME, lindur në Vlorë, më 25.01.1985 dhe banues në Vlorë në adresën: Lagjja "Pavarësia", Rr. Sefer Dauti, Nd. 37, H1, 9404, Vlorë, është themeluar shoqëria me përgjegjësi të kufizuar e quajtur TECHACADEMY shpk, në vijim Shoqëria.

NENI 2

QËNDRA E SHOQËRISË

Shoqëria do të ketë qendrën në Vlorë, në adresën: Rr. Sefer Dauti, Nd. 37, H 1, 9404, Vlorë, Shqipëri dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjensi, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 3

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë (njëqindmijë Lekë) dhe është terësisht kapital financiar i ortakut themelues.

Ortaku i vetëm është zotërues i një kuote me vlerë 100.000 Lekë (njëqindmijë Lekë).

Me vendim të ortakut të vetëm kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet në menyrat e parashikuara nga ligji Nr. 9901 datë 14.04.2008.

NENI 4

KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin për një periudhë 10 vjetësh.

Ajo do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare që nga data e regjistrimit të saj dhe do të ushtrojë veprimtarinë e saj deri më **23.04.2034**.

Shoqëria mund të zgjasë kohën e veprimtarisë së saj ose të shkrihet para kësaj date vetëm me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

5.1 Shoqëria do të ketë objekt të veprimtarisë se saj aktivitetet vijuese :

Shoqëria do të veprojë si qendër formimi profesional në fushën e teknologjisë së informacionit dhe qendër për trajnimin, rekrutimin e stafit të bizneseve, institucioneve sipas kërkesës.

Kurse dhe trajnime profesionale në fushën e Teknologjisë së Informacionit, Inovacionit dhe Robotikës, programeve profesionale të kompjuterit.

Kurse dhe trajnime profesionale në fushën e dizajnit, multimedias dhe animacionit, programe të paketës Adobe, por jo vetëm.

Kurse të formimit profesional në Arkitekturë dhe Inxhinieri, programe të paketës Autodesk, GIS, por jo vetëm.

Konsulencë dhe menaxhim projektsh për Startupe, Incubator, Accelerator, Hackathons, Digital solution, AI, high-tech, etj.

Ofrimi i shërbimeve digjitale, smart solutions, web development, programim, support teknik & ICT, aplikacione dhe projekte të ndryshme të lidhura me teknologjinë dhe inovacionin.

Shitje software-sh dhe produktesh mësimore të ICT dhe Robotikës, sipas moduleve të kurseve, trajnimeve dhe konsulencave që ofron akademia.

Ndërmjetësim rekrutimi për praktika profesionale dhe punësimi në kompani dhe industri të lidhura me TIK, prodhim të automatizuar, etj. Veprimtari për rritjen e bashkëpunimit punëdhënës-punëmarrës.

Kampe Verore dhe Dimërore, si dhe aktivitete jashtëshkollore për fëmijë.

5.2 Shoqëria mund të zhvillojë çdo aktivitet që konsiderohet i nevojshëm a i dobishëm, pa u kufizuar në veprimtaritë e sipërcituara, duke respektuar dispozitat ligjore në fuqi.

5.3 Aktivitetet tregtare mund të kryhen direkt apo në formën e përfaqësive, si në Shqipëri dhe jashtë saj, përfshirë tregtinë me shumicë dhe me pakicë. Shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet tregtare, industriale, të luajtshme e të paluajtshme dhe të kryejë çfarëdo lloj aktiviteti tjetër të lejuar që konsiderohet i nevojshëm për realizimin e objektit të aktivitetit të shoqërisë. Gjithashtu shoqëria mund të marrë pjesë në shoqëri dhe/ose ndërmarrje të çdo natyre që kanë objekt të njejtë, të përafërt apo që lidhet me objektin e veprimtarisë së shoqërisë.

5.4 Shoqëria gjithashtu mund të bashkëpunojë me shoqëri të tjera, me objekt të njejtë ose të ndryshëm nga i saj.


NENI 6 ORGANET DREJTUESE

Administrator i shoqërisë për periudhën e parë 5 vjeçare, duke filluar nga data e themelimit e deri më 23.04.2029 do të jetë znj. MIRBANA LAME.

Shoqëria do të jetë subjekt i së drejtës shqiptare dhe do të ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe me normat e aktit themelues dhe të statutit bashkëngjitur.

Ky akt themelimi nënshkruhet prej ortakut themelues në date 24.04.2024.

ORTAKU THEMELUES

Mirbana Lame 

Vlorë, më 24 Prill 2024 (dymijënjëzet e katër)